



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 175 Akti

Nr. 191 Vendimi

Tiranë, më 26.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 25.7.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Klodjan Braho, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjo i subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Klodjan Braho, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenin 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe pika 1, e nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.9.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues znj. Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 26.6.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Klodjan Braho.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, për subjektin e rivlerësimit (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 1.3.2019), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 15.5.2019.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tria kriteret e vlerësimit; atë të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës në datën 17.7.2019, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit në datën 18.7.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 19.7.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 22.7.2019.

14. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 23.7.2019, duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, si dhe i ka dërguar shpjegimet e tij në rrugë zyrtare,

vendosi të ftojë, z. Klodjan Braho, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail* në datën 23.7.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 25.7.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin e tij individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, kërkoi nga Komisioni, konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Klodjan Braho, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017 dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49, dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komisioni nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Klodjan Braho, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të vitit 2017, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2007 - 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

❖ **Pasuri e paluajtshme**, e llojit apartament, nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 66.88 m², ndodhur në ***, Njësia Administrative ***, Tiranë. Çmimi i blerjes është deklaruar në shumën 29,428 euro. Zotërimi është 100 % nga subjekti i rivlerësimit.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”

Kjo pasuri është deklaruar dhe paguar nga subjekti me katër këste:

- a) Kësti parë: vlera **5,000** euro është paguar në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë, në datën 12.6.2010. Kjo shumë është marrë hua nga babai i subjektit, z. N.B., konfirmuar kjo me deklaratë noteriale datë 10.7.2010. Burimi i këtyre të ardhurave nga babai i subjektit kanë qenë të ardhurat e siguruar nga puna si fermer ndër vite (konfirmuar me vërtetim nga Njësia Administrative ***, Bashkia Skrapar).
- b) Kësti i dytë: vlera **20,000** euro, që i korrespondon shuma 2,800,000 lekë. Kjo shumë është marrë kredi në “BKT” në datën 10.7.2010. Pagesa është bërë me transfertë bankare duke i kaluar investitorit në datën 15.7.2010.
- c) Kësti i tretë: **vlera 3,000 euro**, është paguar nga subjekti në vitin 2015. Burimi i krijimit janë kursimet nga paga.
- d) Kësti i fundit: vlera **1,428** euro, është paguar në vitin 2016. Kjo shumë është siguruar nga kursimet e realizuar në vitin 2015 dhe pjesërisht nga të ardhurat nga paga e punës si prokuror në tremujorin e parë të vitit 2016 të subjektit.

Pronësia e apartamentit është fituar me kontratën e shitblerjes në datën 29.3.2016. Për këtë apartament subjekti disponon certifikatë pronësie nga ZVRPP-ja Tiranë, e cila daton në 29.3.2016. Apartamenti është deklaruar i mobiluar në shumën 150,000 lekë në vit, gjatë viteve 2011 – 2014. Shpenzimet për mobilim janë siguruar nga të ardhurat nga paga si prokuror në vitet respektivë.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e ZQRPP-së dhe DPPP-së.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga hetimet e kryera rezultoi se subjekti e ka blerë pasurinë apartament me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 29.3.2016, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. Vlera e pasurisë është 29,428 euro, shumë e likuiduar plotësisht sipas kontratës së porosisë të datës 12.6.2010.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë porosie me nr. ***, për blerje apartamenti ***, me sip.73.57 m², me vlerë 400 euro/m², në shumën e përgjithshme prej 29,428 euro. Kësti i parë prej 5,000 euro u pagua me nënshkrimin e kontratës. Kësti i dytë prej 20,000 euro do të paguhej me marrjen e kredisë në “BKT” dhe kësti i tretë prej 4,428 euro do të paguhej brenda afatit të mbarimit të pallatit. Subjekti është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie në datën 29.3.2016, për pasurinë nr. ***, me sip. 66.88 m², ndodhur në ***,.

Për blerjen e kësaj pasurie rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë kredie bankare nr. ***, datë 10.7.2010, me “BKT”-në. Dorëzanës për këtë kredi rezultojnë shtetasit N.B., K.B., L. B., dhe shoqëria “****”. Garanci bankare për këtë kredi janë vendosur 2 pasuri të paluajtshme regjistruar në emër të shoqërisë “****”. Vlera e kredisë rezultoi në shumën 2,800,000 lekë. Sipas një dokumenti të ‘BKT’-së rezulton se në datën 15.7.2010 nga subjekti i rivlerësimit ka kaluar në llogarinë bankare të “****” shumën prej 2,800,000 lekësh (kalim shume për blerje apartamenti).

Komisioni pas hetimit të kryer pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me:

- vënien në dispozicion të dokumentacionit provues lidhur me veprimet dhe me të ardhurat e ligjshme të babait në vlerën prej 5,000 euro, të cilat i janë dhënë subjektit si hua në vitin 2010 për pagimin e një kësti për pasurinë apartament;
- dokumentacion provues për pagimin e të gjitha detyrimeve financiare sipas deklaratës së bërë nga subjekti për shoqërinë “****”;
- lidhjen e tij me shoqërinë “****” e cila ka dalë garant dhe dorëzanës për kontratën e kredisë së marrë nga subjekti dhe nëse ka pasur ndonjë çështje gjatë ushtrimit të funksionit me këtë shoqëri;
- kohën e përdorimit nga subjekti të kësaj pasurie.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹ dhe të pyetësorit nr. 3², subjekti ka deklaruar dhe ka paraqitur:

- *Vërtetim nr. *** prot., datë 26.9.2016, të Njesisë Administrative ***, Bashkia Skrapar;*
- *Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi me nr. *** prot., datë 4.1.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dega Berat. Sipas këtij vërtetimi babai i subjektit N.B., që nga viti*

¹ Shikoni përgjigjet e pyetësorit të datës 20.3.2019, protokolluar me shkresën nr. ***, në Komision.

² Shikoni përgjigjen e pyetësorit të datës 27.5.2019, protokolluar me shkresën nr. ***, në Komision.

- 1991 figuron i siguruar si i vetëpunësuar në bujqësi, dhe se nga viti 1993 figuron i regjistruar në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi, dhe se ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 1993 – 2008;
- Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi me nr. *** prot., datë 24.8.2018, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dega Berat. Sipas këtij vërtetimi nëna e subjektit S.B., që nga viti 1991 figuron e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, dhe se nga viti 1993 figuron i regjistruar në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi, dhe se ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 1993-2013;
 - Shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore
 - Tiranë. Sipas kësaj shkrese për personat e vetëpunësuar në bujqësi, kontributet e sigurimeve shoqërore llogariten mbi pagën minimale në shkallë vendi për efekt të sigurimeve shoqërore e cila është e ndryshme çdo vit. Një pjesë e kontributit paguhet nga vetë individi dhe një pjesë subvencionohet nga shteti. Personat e vetëpunësuar në bujqësi kanë të drejtë të paguajnë kontributet çdo vit sa herë që munden ose dëshirojnë. Nisur nga fakti se kontributet paguhen mbi pagën minimale nuk mund të llogariten të ardhurat që i vetëpunësuarit në bujqësi realisht realizon. Këto të ardhura varen nga zona gjeografike ku ushtrohet aktiviteti, si dhe një sërë faktorësh të tjerë.
 - Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ardhurat e siguruara nga vetëpunësimi në bujqësi nuk konsiderohen të ardhura të tatueshme.

Ndërsa lidhur me pagesat e kryera subjekti deklaron:

“Ato janë bërë sipas përcaktimeve të bëra në deklaratën “Vetting”.

Lidhur me marrëdhënien me shoqërinë “***”, theksoj se kjo shoqëri është shoqëria që ka ndërtuar pallatin ku ndodhet apartamenti që kam në pronësi. Kjo shoqëri ka pasur marrëdhënie biznesi si bashkë-investitorë me palën shitëse “***”. Në momentin e marrjes së kredisë në bankë janë vendosur dy pasuri të paluajtshme të shoqërisë “***” si hipotekë për të garantuar marrjen e kredisë.

Këstet për pagimin e detyrimit ndaj shoqërisë “***”, janë bërë sipas deklarimit në deklaratën “Vetting” dhe bashkëlidhur po ju vë në dispozicion dokumentacionin që disponoj. Lidhur me shoqërinë “***” theksoj se kjo është shoqëria që ka ndërtuar pallatin ku ndodhet apartamenti që kam në pronësi. Kjo shoqëri ka pasur marrëdhënie biznesi me shoqërinë “***”, e cila ka qenë dhe bashkë-investitorë në ndërtimin e pallatit ku kam blerë pasurinë. Në momentin e marrjes së kredisë, investitor, shoqëria “***” ka ofruar dy pasuri të paluajtshme për t’u hipotekuar për të garantuar marrjen e kredisë. Në momentin e regjistrimit të apartamentit është ndryshuar dhe garancia e hipotekës duke vendosur apartamentin tim në hipotekë. Me shoqërinë “***” nuk kam pasur asnjë çështje penale dhe kjo shoqëri dhe ortakët e saj nuk rezultojnë të ketë pasur ndonjë çështje penale.

Në apartamentin në fjalë kam filluar të banoj në mënyrë permanente që nga viti 2016 dhe këtë pasuri nuk e kam dhënë ndonjëherë me qira. Në këtë apartament kam banuar edhe në vitin 2005 në disa ditë të veçanta, duke qenë se apartamenti është bërë i banueshëm në vitin 2015. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 kam provuar që babai ka qenë i regjistruar si i vetëpunësuar në bujqësi nga viti 1993 dhe ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore. Referuar legjislacionit përkatës të ardhurat e ligjshme mund të maten me anë të të ardhurave neto, ose me anë të identifikimit të shumës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, duke llogaritur më

*pas të ardhurat neto. Për këtë ju kam vënë në dispozicion shkresën nr. ***, datë 31.1.2019, të ISSH-së Tiranë, ku sqarohet se kontributi për këtë kategori të vetëpunësuar në bujqësi, llogaritet mbi pagën minimale në shkallë vendi. Të ardhurat neto varen nga zona gjeografike, lloji i aktivitetit etj. Nga përmbajtja e dokumentacionit që ju kam vënë në dispozicion nuk është e mundur objektivisht që të llogariten të ardhurat e përfituara nga familjet bujqësore në mënyrë të numërueshme. Fakti se të ardhurat e tyre nuk i kanë depozituar në bankë nuk i bën ato të paligjshme, pasi ligji nuk përcakton ndonjë detyrim.*

*Doja të sillja në vëmendje dhe një rast të praktikës së Komisionit, ku subjekti i rivlerësimit nuk ishte në gjendje të provonte marzhin e fitimit me anë të vlerës së tatimit të paguar, konkretisht sipas vendimit nr. ***, datë 7.2.2019”.*

Subjekti nuk mund të provonte fitimin e realizuar në mënyrë të matshme pasi nuk i nënshtrohej tatimfitimit dhe Komisioni në këtë rast nuk konstatoi elementë kundërshtimorë me shpjegimet e subjektit.

Gjithashtu, Komisioni lidhur me provueshmërinë e burimit të ligjshëm të vlerës së huas prej 5,000 euro i kërkoi subjektit shpjegime edhe në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi:

- *Gjithashtu, duke u nisur nga shuma e paguar e kontributeve, përcaktohet shuma e të ardhurave që iu korrespondojnë vlerës së kontributeve të paguara. Duke i llogaritur për secilin vit vlera totale e të ardhurave rezulton në shumën prej 3,220,560 lekësh.*
- *Vlerat e pagave të llogaritura si më sipër janë marrë referuar shkresës nr. *** prot., datë 9.11.2018, të Institutit të Statistikave.*
- *Llogaritja e shpenzimeve të jetesës për kategorinë e të vetëpunësuarve në bujqësi, nuk është e njëjtë me familjet e tjera dhe mund të përcaktohet saktë.*
- *Gjithashtu, të ardhura të familjes konsiderohen dhe të ardhurat e vëllait i cili ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me prindërit, në shumën totale prej 521,588 lekësh.*
- *Pra, shuma e huas prej 5,000 euro, është vetëm 18.7%, e të ardhurave të realizuara nga sa më sipër kam provuar, si dhe justifikohen këto të ardhura të ligjshme të prindërve.*

Arsyetimi ligjor

Këtë pasuri të paluajtshme, burimin e financimit, subjekti e ka deklaruar saktë si në deklaratën “Vetting” ashtu edhe në deklaratat periodike vjetore.

Marrjen e huas nga babai i tij, z. N.B., subjekti e ka deklaruar dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010. Për më tepër së bashku me këtë deklaratë periodike vjetore subjekti ka paraqitur dhe deklaratë noteriale të datës 10.7.2010.

Bazuar në deklaratën nr. ***, deklaruesi N.B., deklaroi se i ka dhënë djalit të tij, z. Klodjan Braho, shumë prej 5,000 euro në formë huadhënieje për blerjen e apartamentit.

Huan e marrë subjekti e ka deklaruar rregullisht dhe në deklaratat periodike vjetore nga viti 2011 deri në vitin 2016, vit në të cilin subjekti ka deklaruar se e ka shlyer një pjesë të kësaj huaje në vlerën 3,000 euro.

Lidhur me të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar dhe Komisioni ka konstatuar se deklaratimet e tij kanë qenë të sakta dhe se ai ka pasur burime të mjaftueshme financiare të ligjshme për blerjen e saj.

Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit Komisioni arriti në përfundimin se të ardhurat neto të përfituara nga vetëpunësimi në bujqësi nuk janë realisht të matshme. Referuar legjislacionit në fuqi, duke filluar nga viti 1994 e deri më sot objekt taksimi është vetëm sipërfaqja e tokës që zotëron dhe jo të ardhurat që gjeneron toka bujqësore. Fermerët nuk deklarojnë në ardhura lidhur me produktet e tyre. Pas vitit 2012 në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit të TVSH-së për fermerin nëpërmjet të cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSH-së duhet të deklaronin shitjet e tyre.

Si i vetmi rregullim ligjor për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe blegtori është ai i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore në mënyrë vullnetare në mënyrë që të mos humbasin vitet e punës. Tarifa e përcaktuar për këtë kategori llogaritet sipas zonave ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre, p.sh.; zonat malore paguajnë më pak se zonat fushore, pasi ato gjenerojnë më pak të ardhura se zonat fushore³. Sipas legjislacionit në fuqi të vetëpunësuarit në bujqësi dhe blegtori duhet të plotësojnë disa kushte për t'u siguruar si të vetëpunësuar të cilat janë:

- të kenë tokë në pronësi ose në përdorim sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “ Për tokën”, ose akt noterial që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh., qiramarrje etj);
- të ushtrojnë aktivitet bujqësor ose blegtoral;
- të jenë banorë në rrethin që kanë tokën dhe ushtrojnë aktivitetin.

Nga hetimi ka rezultuar se babai i subjektit, z. N.B., ka paguar detyrimet lidhur me sigurimet shoqërore, ka pasur tokë në pronësi, si dhe ka ushtruar aktivitet bujqësor. Komisioni krijoi bindjen se ai ka realizuar të ardhura nga ky aktivitet dhe se ka pasur mundësi financiare në vlerën e dhënies së huas prej 5,000 euro në vitin 2010. Shuma e paguar e kontributeve i korrespondon vlerës së pagës minimale, por i tillë ka qenë edhe vetë legjislacioni në fuqi. Gjithashtu duhet konsideruar edhe faktin se familjet bujqësore shpenzimet e jetesës i kanë më të vogla se familjet e tjera që llogariten nga INSTAT, pasi koston e ushqimit e prodhojnë vetë.

Nga hetimi rezultoi se babai i subjektit e ka ushtruar aktivitetin si i vetëpunësuar në bujqësi nga viti 1993 deri në vitin 2010 (vit të cilin i ka dhënë hua vlerën 5,000 euro subjektit të rivlerësimit), edhe nëse llogarisim të ardhurat në raport me nivelin minimal të pagesës së sigurimeve shoqërore për efekt të llogaritjes së mundësisë financiare të babait të subjektit, rezulton se mundësitë financiare për të kursyer çdo vit ishin në një mesatare vjetore prej 40,000 (dyzet mijë) lekësh dhe për rrjedhojë babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për dhënien e huas subjektit në vlerën 5,000 euro në vitin 2010.

³ Për zonat fushore masa është 9,600 lekë në tremujorë dhe për zonat malore është 7,350 lekë në tremujor, sqaron ISSH.

<http://lexo.com.al/te-vetepunësuarit-ne-bujqësi-sa-duhet-te-paguajnë-për-te-marrë-pension/>

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar problematika të tjera lidhur me deklarimin e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”.

Në përfundim pasi analizoi faktet, rrethanat dhe provat e administruara, Komisioni krijoi bindjen se subjekti është në pamundësi objektive të përcaktojë të ardhurat neto të babait deri në vitin 2010, kohë kur është dhënë hua shuma prej 5,000 euro, por ai arriti të provojë me dokumente ligjorë se prindërit e tij kanë qenë të vetëpunësuar në bujqësi dhe të deklaruar si të tillë, ata kanë ushtruar veprimtari bujqësore në formën e vetëpunësimit nga e cila edhe kanë gjeneruar të ardhura të ligjshme. Në përfundim Komisioni krijoi bindjen se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për krijimin e shumës prej 5,000 euro deri në vitin 2010. Ata kanë materializuar dhënien e kësaj huaje nëpërmjet një dokumenti dhe subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë huamarrjen dhe shlyerjen e saj nëpërmjet deklarimeve periodike.

- ❖ **Automjet**, me targa AA ***, i blerë me kontratën nr. ***, datë 7.7.2016, në vlerën 400,000 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- shuma prej 50.000 lekësh, e siguruar nga të ardhurat nga paga si prokuror;
- shuma prej 350.000 lekësh, e siguruar nga shitja e një automjeti të mëparshëm me targa TR ***, në datën 3.3.2016.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e DPSHTRR.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga hetimi i kryer nga Komisioni konstatoi se ky automjet është blerë me kontratën nr. ***, datë 4.7.2016, nga shtetasi R. F. Vlera e blerjes është 400,000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Me kontratën nr. ***, datë 3.3.2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka shitur automjetin me targa TR ***, në vlerën prej 350,000 lekësh.

Për të vërtetuar deklaratimet e tij subjekti ka paraqitur dhe kontratën nr. ***, ku vërtetohet se subjekti ka blerë një automjet në datën 20.3.2010, në vlerën 250,000 lekë. Automjeti me targa TR ***, është blerë me kontratën e datës 20.03.2010, në vlerën 250.000 lekë, shumë në të cilën nuk janë të përfshira detyrimet doganore. Kjo vlerë për blerjen e këtij automjeti është siguruar nga kursimet nga paga si prokuror në vitet 2007 dhe 2008.

Detyrimet doganore të këtij automjeti me targa TR ***, janë paguar në shumën 372,200 lekë, në vitin 2011 (vërtetuar me vërtetim bankar). Burimi i deklaruar janë kursime nga paga në vitet 2009 dhe 2010⁴.

Në deklaratën periodike për vitin 2011 subjekti nuk e ka deklaruar të plotë vlerën për blerjen e mjetit pasi nuk ka deklaruar shpenzimet doganore në vlerën prej 372,200 lekësh. Në analizën

⁴ Shikoni përgjigjen e subjektit të datës 27.5.2019.

financiare është përfshirë nga Komisioni dhe shpenzimi i kryer nga subjekti në vlerën 372,200 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarin e këtij mjeti në deklaratën “Vetting”. Në analizën financiare janë përfshirë të gjitha ndryshimet e likuiditeteve për shitblerjet e automjeteve nga subjekti.

- ❖ **Të holla** në shumën 132,561.65 lekë. Nga kjo shumë, vlera 50.000 lekë është *cash*, kurse pjesa tjetër në llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- Të ardhurat nga ISSH-ja Tiranë, leja e lindjes së bashkëshortes.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht deklarimi i përket datës 18.1.2017 ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 20.1.2017.

Sipas dokumentacionit të “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresës nr. ***, datë 25.1.2019, në dosjen e Komisionit, bashkëshortja e subjektit ka llogari bankare në këtë bankë. Vlera deri në datën 18.1.2017 është 132,561 lekë. Këtë llogari subjekti e ka deklaruar dhe në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar parregullsi për këtë llogari bankare. Veprimet financiare lidhur me lëvizjet e likuiditeteve për këtë llogari bankare të kryera nga subjekti janë përfshirë në analizën financiare.

- ❖ **Të ardhura** në shumën 125.369,45 lekë, të ndodhura në llogarinë bankare të kursimit në “Raiffeisen Bank”. Kjo shumë është pjesë e të ardhurave të siguruar gjatë martesës. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- Të ardhurat nga paga nga puna si prokuror për vitin 2016.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Sipas dokumentacionit të “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresës nr. *** prot., datë 25.1.2019, në dosjen e Komisionit rezultoi se subjekti ka llogari bankare në këtë bankë. Vlera deri në datën 5.1.2017 është 125,369 lekë. Kjo llogari është deklaruar nga subjekti dhe në deklaratat periodike vjetore.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar parregullsi për këtë llogari bankare. Veprimet financiare lidhur me lëvizjet e likuiditeteve për këtë llogari bankare janë përfshirë në analizën financiare.

- ❖ **Llogari bankare kursimi** në “Raiffeisen Bank”, në shumën 20,013.4 lekë, në emër të bashkëshortes, plus interesa, në bashkëpronësi 50 %. Gjendja aktuale e kësaj llogarie bankare është në shumën 110,048.38 lekë, por pjesa tjetër e kësaj shume janë të ardhura të realizuara para martese nga bashkëshortja.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- Të ardhura nga puna e bashkëshortes në ZQRPP-në Tiranë.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Sipas dokumentacionit të “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresës nr. *** prot., datë 25.1.2019, në dosjen e Komisionit rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka llogari bankare në këtë bankë. Vlera deri në datën 18.1.2017 është 110,048 lekë. Kjo llogari është e krijuar nga të ardhurat e punës së bashkëshortes së subjektit.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar parregullsi për këtë llogari bankare. Veprimet financiare lidhur me lëvizjet e likuiditeteve për këtë llogari bankare janë përfshirë në analizën financiare.

- ❖ **Llogari bankare në euro** në “Raiffeisen Bank” e lidhur me kartë krediti me kufi deri në 500 euro. Llogaria është në funksion të pagesës së kartës së kreditit.

Gjendja e llogarisë në datën 20.1.2017 është zero, kurse gjendja e kartës së kreditit është në shumën - 294 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Sipas dokumentacionit të “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së subjekti ka llogari bankare në këtë bankë. Vlera deri në datën 18.1.2017 është 0 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Veprimet financiare lidhur me lëvizjet e likuiditeteve për këtë llogari bankare janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare

- ❖ **Llogari rrjedhëse** në “Raiffeisen Bank” e cila përdoret për tërheqjen e pagës si prokuror. Me këtë llogari është i lidhur një *overdraft* në shumën 100,000 lekë.

Gjendja e llogarisë në datën 20.1.2017 është në shumën - 50.376,3 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Konstatim i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Sipas dokumentacionit të “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresës nr. *** prot., datë 25.1.2019, në dosjen e Komisionit, subjekti ka llogari bankare në këtë bankë. Vlera deri në datën 18.1.2017 është -50,376 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Nuk janë konstatuar parregullsi për këtë llogari bankare. Veprimet financiare lidhur me lëvizjet e likuiditeteve për këtë llogari bankare janë përfshirë në analizën financiare.

- ❖ **Shuma prej 5.000 lekësh** e përfituar nga Bashkia Tiranë si shpërblim për lindjen e djalit dhe e ndodhur “NBG”. Pjesa takuese: 50 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “NBG”-së.

Bazuar në përgjigjen e “NBG”-së rezultoi se në këtë llogari bankare ka kaluar shuma prej 5,000 lekësh si shpërblim për lindjen e djalit.

Në përfundim konstatohet se:

Nuk janë konstatuar parregullsi të tjera për këtë llogari bankare.

- ❖ **Llogari bankare depozitë** në “Raiffeisen Bank” në vlerën 2,000.22 euro.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- Të ardhurat nga marrëdhëniet e punës.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

Sipas dokumentacionit të “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresës nr. *** prot., datë 25.1.2019, në dosjen e Komisionit rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka llogari bankare në këtë bankë. Vlera deri në datën 18.1.2017 është 2,000.22 euro.

Në përfundim konstatohet se:

Nuk janë konstatuar parregullsi për këtë llogari bankare. Veprimet financiare lidhur me lëvizjet e likuiditeteve për këtë llogari bankare janë përfshirë në analizën financiare.

- ❖ **Gjendje cash** në vlerën 2,000 euro. Burimi i të ardhurave nga marrëdhëniet e punës.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Subjekti ka mundësi financiare nga të ardhurat nga pagat për krijimin e kësaj vlere.

Në përfundim konstatohet se:

Këtë gjendje *cash* subjekti e ka deklaruar dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016. Në analizën financiare janë pasqyruar mundësitë e subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 2,000 euro.

- ❖ **Bashkëpronare** në 1/5 e pasurisë së paluajtshme, shtëpi banimi dhe truall me sip. 70 m² dhe 300 m², në Vlorë (bashkëshortja e subjektit). Nuk përcaktohet vlera e pasurisë.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë. Pasuria është në emër të z. A.V., (babai i bashkëshortes së subjektit).

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se:

Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së pasuria me nr. ***, z.k. ***, me sip. 300 m² truall dhe 70 m² ndërtim është e regjistruar në emër të z. A. V.

Lidhur me këtë konstatim është pyetur subjekti i cili ka kthyer përgjigje sipas pyetësorit⁵ ku ka deklaruar:

- *kjo pasuri është regjistruar në bazë të listës së trojeve sipas VKM-së nr. 432, datë 14.8.1995;*
- *pasuria është regjistruar në emër të kryefamiljarit, por pronësia është fituar mbi bazën e ligjit dhe pronësia i përket të gjithë anëtarëve të familjes;*
- *në kartelën e pasurisë është shënuar germa (F) që do të thotë se pasuria është në bashkëpronësi të familjes bujqësore.*

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni, pas analizimit të fakteve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk konstatoi parregullsi për këtë pasuri të deklaruar nga subjekti, e cila është përfituar nga bashkëshortja e tij si pasuri në bashkëpronësi që në vitin 1995.

- ❖ **Automjet, tip “Mercedes Benz”,** me targa AA ***. Blerë në vlerën 500 euro dhe detyrimet doganore 34,337 lekë, nga të ardhurat nga puna.

Konstatim i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e DPSHTRR-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2019, DPSHTRR-ja ka dërguar të dhënat për automjetin me targa AA ***, në pronësi të bashkëshortes së subjektit. Kjo pasuri është blerë nga vëllai i bashkëshortes së subjektit, z. E.V., dhe më pas i ka kaluar bashkëshortes së subjektit znj. A. V. në datën 2.12.2014.

Në përfundim konstatohet se:

Nuk janë konstatuar parregullsi për këtë pasuri të deklaruar nga subjekti.

❖ **Konstatime të tjera**

Lidhur me përdorimin e pasurive të paluajshme si adresë banimi

Komisioni konstatoi se në përgjigje të pyetësorit të parë subjekti ka deklaruar se nga viti 2003 deri në vitin 2017 ka qenë i regjistruar në gjendjen civile me adresë: Rr. “****”, pall. ***, shk. ***, e cila ka qenë banesë vetëm për regjistrim në gjendjen civile Njësia Nr. ***, Tiranë. Për periudhën 2011 – 2016 subjekti ka jetuar në banesë me qira në Berat dhe Vlorë dhe nuk ka lidhur ndonjë kontratë me shkrim. Për periudhën nga shkurti 2016 ka jetuar në adresën pallati ***, ***, ***, Tiranë.

Bazuar për sa më sipër, për subjektin e rivlerësimit u përgatit pyetësori nr. 2, i cili ka deklaruar: *“Në Njësinë Administrative Nr. *** kam qenë i regjistruar në vitin 2003 kur kam qenë student, por kam ndenjtur në qytet student. Kjo adresë i përket xhaxhit të djalit të tezes z.A.B., dhe kjo pasuri është përdorur vetëm për regjistrim në gjendjen civile. Për këtë pasuri nuk kam kryer ndonjë veprim dhe as ndonjë shpenzim.*

Vlera e qirasë në qytetin e Beratit për periudhën 2011 – 2012 ka qenë në shumën 5,000 lekë në muaj, kurse në qytetin e Vlorës për periudhën 2012 – 2016 në vlerën 7,000 lekë në muaj”.

⁵ Shikoni përgjigjen e subjektit në datën 27.5.2019 në dosjen e Komisionit.

Lidhur me pasurinë në Rr. “***” është dërguar shkresë nga Komisioni në njësinë vendore për regjistrimin e subjektit pranë kësaj gjendjeje civile, dhe i është dërguar shkresë ZVRPP-së Tiranë lidhur me pronarin e kësaj pasurie.

Njësia Administrative Nr. *** Tiranë ka kthyer përgjigje ku rezulton se subjekti i rivlerësimit është regjistruar në këtë njësi në datën 22.2.2005. Kjo njësi vendore nuk disponon dokumentacionin e regjistrimit të subjektit të rivlerësimit përveç një kopje të regjistrimit përkatës.

Në përfundim konstatohet se:

Subjekti ka përdorur pasurinë e z. A.B., (apartament) për t’u regjistruar si banor i njësisë administrative përkatëse dhe për rrjedhojë si qytetar i bashkisë Tiranë, përpara fillimit të detyrës si prokuror, por ka deklaruar gjithashtu se nuk ka banuar asnjë herë në këtë apartament⁶. Lidhur me kontratat e qirasë në qytetin e Beratit dhe të Vlorës ato mbetën në fazën e deklarimeve, pasi subjekti nuk ka paraqitur dhe nuk disponon kontratat përkatëse. Të dhënat për shpenzimet e qirasë janë pasqyruar nga Komisioni në analizën financiare.

Lidhur me kreditë e marra nga bashkëshortja e subjektit

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar:

“Kreditë e marra në vitin 2010 dhe 2011 janë paguar nga babai i bashkëshortes. Në vitin 2010 dhe 2011, kur janë marrë kreditë bashkëshortja banonte dhe ka qenë në përbërje familjare me prindërit dhe dy vëllezërit, të cilët kanë qenë dhe punojnë emigrantë në Itali. Unë si subjekt jam martuar në datën 31.8.2016. Duke qenë se bashkëshortja ime ishte personi që kishte llogari bankare dhe vjehrrin ishte në moshë relativisht të madhe, duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret e bankës për dhënien e kredive, është vendosur që bashkëshortja të mos ishte vetëm dorëzanëse por dhe bashkëkreditore, në mënyrë që banka të kishte siguri maksimale. Të ardhurat e vjehrrit burojnë nga vetëpunësimi në bujqësi, si dhe të ardhurat e dy fëmijëve emigrantë në Itali. Bashkëlidhur dokumentacionin provues”.

Lidhur me kreditë rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka qenë bashkëkredimarrëse në bankë për të dyja kreditë. Kredia e parë është marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2010 në vlerën 1,490,000 lekë dhe është shlyer në datën 1.9.2015, në kohën kur bashkëshortja e subjektit nuk ka qenë e martuar, por në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 subjekti ka deklaruar bashkëjetesën, si dhe të ardhurat dhe pasuritë e bashkëjetueses. Në përgjigje për këtë çështje subjekti ka deklaruar se në muajin dhjetor 2015 ka filluar lidhja e tij me bashkëshorten A. V. Në kontratën e kredisë rezultojnë si hipotekues vëllezërit e bashkëshortes së subjektit, K., dhe E.V. Shlyerja e kredisë është bërë më këste dhe nga viti 2010 deri më datën e mbylljes së kredisë (1.9.2015) është shlyer shuma në total prej 2,135,225 lekësh. Për vitin 2015 është shlyer shuma prej 877,328 lekësh. Sipas deklaramit të subjektit bashkëshortja e tij nuk ka kontribuar në shlyerjen e kësteve të kredisë, por kontribuues ka qenë babai dhe të dy vëllezërit e saj. Babai i bashkëshortes ka qenë i vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993 dhe ka provuar se ka paguar detyrimet lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore, por nuk mund të llogariten të ardhurat neto lidhur me këtë aktivitet fitimprurës.

⁶ Shikoni përgjigjet e subjektit sipas pyetësorit nr. 2 në datën 20.3.2019

Kredia e dytë është marrë në vitin 2011 në “Raiffeisen Bank” në vlerën 46,660 euro, me qëllim blerje apartamenti në Vlorë nga prindërit e bashkëshortes së subjektit. Për këtë kredi deri në vitin 2016 është shlyer shuma prej 3,223,403 lekë.

Lidhur me të ardhurat e babait të bashkëshortes së subjektit, pasi subjekti ka paraqitur dokumentacion provues rezulton se pavarësisht se ka qenë i vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993 dhe ka paguar kontributet për sigurimet shoqërore, të ardhurat e tij nuk janë të matshme.

Lidhur me të ardhurat e dy fëmijëve të babait të bashkëshortes së subjektit, bazuar në dokumentacionin të sjellë nga subjekti i rivlerësimit rezulton se të ardhurat e tyre për periudhën 2010 – 2016, duke zbritur shpenzimet e jetesës, kanë qenë në vlerën rreth 15 milion lekë.

Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga marrëdhëniet e punës ka rezultuar:

- Për periudhën 2008 – 2015 të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë qenë në shumën *neto* 3,450,609 lekë.
- Vlera e shlyerjes së dy kredive deri në vitin 2016 ka qenë në vlerën 5,358,628 lekë.
- Bashkëshortja ka pasur këtë periudhë dhe llogari bankare në vlerën 8,000 euro (1,101,200 lekë).

Në një vlerësim të përgjithshëm, duke e konsideruar bashkëshorten e subjektit si bashkëkredimarrëse, për kredinë e cila vazhdon të shlyhet edhe sot, ka rezultuar se shlyerja e kredisë është bërë nga babai dhe vëllezërit bazuar në burimet e ligjshme. Gjithashtu ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka pasur mundësi financiare për të shlyer gjysmën e vlerës së kredisë deri në vitin 2016 bazuar, kjo në të ardhurat e ligjshme të krijuara nga marrëdhëniet e punës për këtë periudhë.

Lidhur me përdorimin e apartamentit me qira në Vlorë

Për këtë çështje ka pasur një denoncim nga shtetasi E.D. Është pyetur subjekti i rivlerësimit i cili ka deklaruar se apartamenti ku ka qëndruar ka qenë në pronësi të shtetasit Z.F., person i cili ka pasur njohje familjare me familjen e subjektit. Apartamenti ndodhet në Rr. “****”, Vlorë. Detyrimet për OSHEE-në, UK-në Vlorë, dhe Bashkinë nuk janë kryer fizikisht nga subjekti por nga pronari i pasurisë i cili për këtë ka paraqitur dhe dokumentacion shkresor⁷.

Denoncimi i shtetasit E.D., është bërë për me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur lidhje me shtetasin S.F., dhe se i ka përdorur pasuritë e këtij shtetasi gjatë periudhës së qëndrimit në qytetin e Vlorës. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka banuar me qira në shtëpinë e Z.F., dhe për këtë subjekti ka paraqitur dhe dokumentacion provues. Lidhur me këtë është vënë në dispozicion dhe deklarata noteriale e datës 12.04.2016, ku deklarohet se shtetasi Z.F., i ka lënë në përdorim shtetasit Klodjan Braho, apartamentin e tij me qira në vlerën 7,000 lekë në muaj për periudhën maj 2012 deri në shkurt 2016.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shtëpia ku ai ka banuar me qira ishte afër vendit të punës dhe ishte komode dhe praktike për kërkesat e tij. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit

⁷ Shikoni përgjigjen e subjektit të rivlerësimit të datës 5.7.2019 dhe dokumentacionin shoqërues.

dokumentacion ligjor provues lidhur me banesën e tij në këtë shtëpi si dhe mundësitë e shtetasit Z.F, për të jetuar në një shtëpi tjetër po në qytetin e Vlorës.

Komisioni gjatë hetimit nuk konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës të ushtrimit të detyrës në qytetin e Vlorës të ketë përdorur pasuri të shtetasit S.F.

Nga administrimi i shkresave dhe i provave të tjera që ndodhen në dosjen e Komisionit lidhur me hetimin e kryer, nuk rezultuan indice lidhur me vlerësime të fakteve dhe rrethanave të tjera për kriterin e pasurisë.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE FINANCIARE

	I	II	III	IV = (II-III)	V	VI = I -IV - V
Viti	Të ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria neto	Shpenzime	Rezultati
2007	527 517	79 571	0	79 571	352 287	95 659
2008	1 083 647	200 000	0	200 000	196 620	687 027
2009	996 282	200 000	0	200 000	196 620	599 662
2010	1 067 991	4 324 901	4 090 119	234 781	397 216	435 994
2011	1 185 610	50 000	-55 526	105 526	461 265	618 819
2012	1 088 509	150 000	-57 291	207 291	676 657	204 561
2013	1 111 166	200 000	-69 075	269 075	792 618	49 472
2014	1 342 013	96 759	-94 062	190 820	748 188	403 005
2015	3 410 895	878 342	-520 121	1 398 463	907 633	1 104 799
2016	2 401 266	-322 525	-720 545	398 021	1 140 488	862 758
TOTAL	14 214 896	5 857 048	2 573 499	3 283 549	5 873 091	

Komisioni, gjatë kësaj analize është bazuar në:

- a. gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur;
- b. të ardhurat e ligjshme nga marrëdhëniet e punës;
- c. shpenzimet e kryera nga subjekti dhe personat e lidhur;
- ç. në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.

Në analizën financiare është përfshirë dhe vlera prej 5,000 euro, që është dhënë hua nga babai i subjektit për pagimin e këstit për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2010.

Subjekti, në deklaratat periodike vjetore, ka deklaruar shtesa në të holla për secilin vit përkatës, por pa specifikuar nëse shtesa në të holla nënkuptonte si gjendjen *cash* dhe ndryshimet e likuiditeteve bankare, apo vetëm gjendjen *cash*. Për këtë u pyet subjekti dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka kthyer përgjigje, duke deklaruar se në deklaratat periodike ka deklaruar si shtesa në të holla si gjendjen e likuiditeteve dhe gjendjen *cash* për secilin vit.

Bazuar në përgjigjen e subjektit, deklarimeve në deklaratën “Vetting” dhe deklarimeve në deklaratat periodike vjetore, është hartuar edhe analiza financiare duke llogaritur shtimet e likuiditeteve për secilin vit dhe diferenca është llogaritur si gjendje *cash* e subjektit.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni, bazuar në analizën financiare, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme për vitet në të cilat ka ushtruar funksionet e prokurorit për periudhën 2007 – 2016.

Nga administrimi i shkresave dhe provave të tjera që ndodhen në dosjen e Komisionit lidhur me hetimin e kryer nuk rezultuan indice lidhur me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të tjera për kriterin e pasurisë.

B. NË LIDHJE ME KONTROLLIN E FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim, nr. ***, datë 1.3.2019, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: **“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Klodjan Braho”**.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Në Komision është paraqitur dhe një denoncim nga shtetasi E.D., protokolluar në Komision në datën 25.6.2019. Denoncuesi ka paraqitur të dhëna lidhur me kunatin e subjektit të rivlerësimit (vëllain e gruas), lidhur me veprimtari të kundërligjshme të tij në shtetin italian dhe përfitim të pasurive nga ai, bazuar në favore të bëra nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni pas denoncimit ka kryer disa kërkime nga ku ka rezultuar se sipas fakteve të njohura botërisht (<http://ëëë.romagnanoi.it/neës/ravenna/440214/Eroina-e-coca--in-tre.html>), shtetasi E.V., ishte arrestuar në shtetin italian në vitin 2011.

Në lidhje me këtë denoncim ju kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit⁸ ka paraqitur shpjegimet e tij për këtë çështje ku sqaron:

“Shtetasi E.V., është vëllai i bashkëshortes, i cili punon si emigrant ekonomik në Itali; Jam njohur me artikullin në internet të dërguar nga Komisioni, për të dhënat lidhur me dënimin e shtetasit E.V. Artikulli mban datën 27.05.2011 dhe nuk kam pasur mundësi objektive dhe reale që të kem pasur dijeni për këtë çështje. Në këtë periudhë kam qenë në detyrë në qytetin e Beratit. Me bashkëshorten jam lidhur në vitin 2015 dhe jam martuar në vitin 2016, pesë vjet më vonë nga koha kur është botuar artikulli në mediat e huaja. Nga verifikimet e kryera në Shqipëri nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për aktivitet të kundërligjshëm të shtetasit E.V., dhe figuron sipas gjendjes gjyqësore si person “I padënuar”.

⁸ Shikoni shpjegimet e subjektit të datës 22.7.2019, faqe 24 - 29, si dhe dokumentacionin shkresor të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur.

Periudhën më të madhe të kohës E.V., ka ndejtur në shtetin Italian, sipas të dhënave të konfirmuara nga sistemi TIMS.

Kontaktet e mia kanë qenë të rralla, vetëm në rastet e takimeve në shtëpinë e vjehrrit, ku ka rastisur të ketë qenë i pranishëm dhe E.V.

Sipas sistemit TIMS ky shtetas gjatë periudhës 2011 – 2019 ka hyrë dhe ka dalë jashtë vendit disa herë, lirisht dhe nuk është krijuar përshtypja që ky person mund të ketë pasur probleme në shtetin e huaj.

Në momentin e plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës në janar 2017, periudhë vetëm pak muaj nga koha e lidhjes së martesës, pyetjes nëse personat e lidhur janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, i jam përgjigjur me vërtetësi, pasi atë periudhë nuk kam pasur asnjë dijeni për ekzistencën e ndonjë fakti të tillë”.

Komisioni , bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në analizën e fakteve, vlerësoi se:

- Shtetasi E.V., përfshihet në rrethin e personave të lidhur, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për deklarim sipas “Deklaratës për kontrollin e figurës”. Sipas kësaj deklaratë me termin “anëtar familje” do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqitë deri në shkallë të dytë. Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa 5, të dhëna për sigurinë, subjekti ka deklaruar se nuk ka dijeni se një nga anëtarët e familjes është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni për ushtrim të aktivitetit të paligjshëm të kumatit E.V., në shtetin italian. Ai ka njohur bashkëshorten e tij (motrën e E.V.) në vitin 2015 dhe nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit është martuar në fund të muajit gusht 2016 dhe se deklaratën për kontrollin e figurës e ka plotësuar në muajin janar të vitit 2017. Nga verifikimet e kryera rezultoi se sipas sistemit TIMS shtetasi E.V., ka qëndruar në Shqipëri për periudha shumë të shkurtra (nga muaji gusht 2016 deri në janar 2016 ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm 2 herë në datën 30.9.2016 dhe ka dalë në datën 1.10.2016 dhe në datën 16.11.2016 dhe ka dalë në datën 18.11.2016). Pra, këto dy qëndrime për këtë periudhë të shtetasit E.V., vetëm 3 ditë gjithsej, krijojnë bindjen për Komisionin se kontaktet e subjektit të rivlerësimit me të kanë qenë të rralla.
- Bazuar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. *** prot., datë 20.07.2019, rezultoi se shtetasi E.A.V., lindur në datën 30.10.1986, është i padënuar.
- Periudha e arrestimit të shtetasit E.V., në shtetin italian është e vitit 2011. Bazuar në nenin DH “kontrolli i figurës” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit sipas ligjit.
- Subjekti paraqiti para Komisionit shpjegime dhe fakte se marrëdhëniet e tij me shtetasin E.V., kanë qenë të rralla.

Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në hetimin e kryer për këtë çështje, krijoi bindjen se subjekti nuk ka pasur kontakte të vazhdueshme me shtetasin E.V. Kjo rrethanë e kontakteve të rralla familjare, se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni për arrestimin e

kunatit E.V., u mor në konsideratë nga Komisioni si rrethanë lehtësuese në përputhje me pikën 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni krijoi bindjen se përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ishin bindëse, se ai ka qenë i besueshëm, i hapur dhe i plotë në deklaratimet e tij lidhur me dijeninë e arrestimit dhe kontaktet e rralla me shtetasin E.V. Gjatë hetimit Komisioni nuk konstatoi asnjë indice apo të dhënë për dijeninë e subjektit lidhur me arrestimin e kunatit të tij, z. E.V., në vitin 2012.

C. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Klodjan Braho, është përgatitur nga KLP-ja bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar dhe bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit dhe të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosjet/praktikat penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar nga relatori i cili ka paraqitur përpara trupit gjykues të Komisionit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Klodjan Braho, në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

❖ 5 DOSJET E PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja nr. 1

- *Gjetjet në dokumentin ligjor: “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015”, akt i datës 18.9.2015, për veprën penale të “falsifikim i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.*

Dosja nr. 2

- *Gjetjet në dokumentin ligjor: “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013”, regjistruar për veprën penale të “përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.*

Dosja nr. 3

- *Gjetjet në dokumentin ligjor: “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2013”, akt i datës 30.12.2013, marrë në kuadër të procedimit penal nr. *** të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Dosja nr. 4

- *Gjetjet në dokumentin ligjor: “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2015”, akt i datës 13.10.2015, marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Dosja nr. 5

- *Gjetjet në dokumentin ligjor: “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016”, akt i datës 12.05.2016, marrë në kuadër të kallëzimit penal nr. ***, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.*

Lidhur me këtë çështje të fundit Komisioni konstatoi se vendimi i mosfillimit nuk ishte marrë brenda afatit tridhjetë ditor, i caktuar me Udhëzimin nr. 241, datë 22.11.2005, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” të Prokurorit të Përgjithshëm.

Lidhur me këtë dhe me disa gjetje të Komisionit subjektivit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime, i cili i paraqiti në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹.

❖ ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit:

- formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti;
- pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short;
- të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga analiza e dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Klodjan Braho, për sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi mjaft të mira në drejtim të zbatimit të ligjit.

Në përgatitjen e akteve subjekti i rivlerësimit përgjithësisht respekton dispozitat procedurale penale, por edhe Urdhrin nr. 174, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”, Urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e Shkallës së Parë” Udhëzimit me nr. 265, datë 4.12.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpenzimet procedurale”, Udhëzimit me nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, ka aftësi shumë të mira në arsyetim ligjor. Aktet e përgatitura prej tij paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimorë dhe etike. Subjekti i rivlerësimit arsyeton qartë duke referuar drejt në dispozitat ligjore përkatëse penale, procedurale dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese.

Rezultoi se për periudhën e punës si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjektivit i janë caktuar për ndjekje gjithsej 196 çështje (për periudhën 08.10.2013 – 20.02.2016), nga të cilat 60 çështje janë mosfilluar, 71 çështje të pushuara, 43 çështje dërguar për gjykim. Pjesa tjetër prej 22 procedimesh janë pezulluar.

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, ka treguar aftësi shumë të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrit të çështjeve të caktuara në raport me ato të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

⁹ Shikoni përgjigjet e subjektivit me nr. *** prot., datës 22.7.2019.

Subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive.

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit është angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe nga institucione të tjera, qoftë në rolin e pjesëmarrësit, qoftë si lektor. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Klodjan Braho, i është nënshtruar programit të formimit vazhduar të Shkollës së Magjistraturës.

❖ TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, si dhe burimet në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho:

- *Të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer.*
- *Të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.*
- *Të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike), të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).*
- *Të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, të pushuara, apo të pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.*
- *Subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, për vitin 2014, 2015 dhe 2016, ka vlerësimin “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm.*

Komisioni, bazuar në të dhënat e Prokurorisë së Përgjithshme, konstatoi disa çështje të ndjekura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe Prokuroria e Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit dhe konkretisht për çështjet:

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, referuar shkresës nr. *** prot., datë 20.3.2019, ka pasur regjistrim të kallëzimit penal nr. *** , datë 20.10.2014, të shtetasit N.D., ndaj prokurorit Klodjan Braho për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në përfundim nuk konstatoi elementë të veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”, apo të ndonjë vepre tjetër penale. Prokurori ka kryer ato veprime hetimore të cilat në gjykimin e tij kanë qenë të nevojshme për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të çështjes dhe më e rëndësishmja gjatë kryerjes së hetimeve prokurorët kanë respektuar të gjitha rregullat procedurale.

- Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 7.3.2019, është marrë vendimi për mosfillimin e kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2013, të kallëzimit të shtetases K.Rr., ndaj prokurorit Klodjan Braho. Nga të dhënat e materialit kallëzues rezulton se vetë kallëzuesja ka ankimuar vendimin për pushimin e ndjekjes penale ndaj këtyre personave dhe çështja është në shqyrtim në Gjykatës e Shkallës së Parë Vlorë. Përfundimisht, është vendosur se nuk rezultojnë në asnjë rast elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për kallëzimin penal të shtetases K.Rr., ndaj prokurorit Klodjan Braho.
- Shtetasi A.L., nga Vlora, ish-oficer i policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë, i është drejtuar me një *e-mail* Prokurorit të Përgjithshëm ku ankohet për arrestim të padrejtë të bashkëshortes së tij, znj. B.L., në korrik të vitit 2011, e akuzuar për veprat penale falsifikim dokumentesh dhe shkelje e barazisë në tender dhe ankande publike. Konstatohet se kjo ankesë i ka kaluar Sektorit të Task - Forcës (Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale). Shefi i këtij sektorit prokurori M.K., i ka dërguar *e-mail* ankuesit A. L., duke i lënë një datë dhe orë për t’u paraqitur dhe për të prezantuar shqetësimin e tij. Më pas konstatohet që kjo praktikë është arkivuar pasi është komunikuar me ankuesin në datën 17.10.2013 dhe shënimi është bërë nga prokurori M.K.
- Shoqëria “****” sh.a., i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm shfuqizimin e vendimit të pushimit në datën 4.10.2013 në lidhje me procedimin penal nr. ***, marrë nga prokurori Klodjan Braho. Sipas ankuesit pretendohet se në lidhje me procedimin penal nr. ***, të vitit 2007, është hetuar dhe është marrë vendimi për pushimin e procedimit penal në datën 26.11.2007 nga prokurori M.S., për arsye se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, në bazë të nenit 328 (b) të Kodit të Procedurës Penale. Kështu, kallëzuesja K.Sh., ka qenë pronare e një sipërfaqe trualli prej 4900 m² dhe të objekteve, depozita karburanti, të ndodhura në këtë truall, në të cilën është ndërtuar terminali nga shoqëria “****”. Kallëzuesja ka pretenduar se procedura e shpronësimit të saj ka filluar tre muaj pas prishjes së objekteve. Në këtë mënyrë ajo ka pretenduar për ekzistencën e veprës penale të “shkatërrimit të pronës me dashje”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Kallëzuesja K.Sh., nuk ka bërë ankim ndaj këtij vendimi në vitin 2007, por vetëm në vitin 2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për prishjen e këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me gjyqtar A.B., pasi ka dëgjuar kërkesat e palëve dhe të prokurorit Klodjan Braho, i cili ka kërkuar që vendimi i pushimit të lihej në fuqi, pasi nga koha e ndodhjes së faktit deri në momentin e gjykimit të çështjes ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale, përfundimisht ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal dhe detyrimin e prokurorisë për të vazhduar hetimet. Sipas ankuesit, prokurori ka vepruar në mënyrë të paligjshme pasi nuk ka bërë ankim ndaj këtij vendimi dhe ka vazhduar hetimet, ndërkohë që kishte pengesë ligjore për të vazhduar hetimet, pasi ishte parashkruar ndjekja penale. Në lidhje me këtë ankesë nga Prokuroria e Përgjithshme është marrë një kopje e dosjes penale nr. ***, e vitit 2007, nga Prokuroria e Rrethit Vlorë, dhe pas studimit të saj është konstatuar si më poshtë:

“Pasi u shqyrtuan aktet e dosjes në fjalë, u konkludua se nuk ka shkaqe ligjore për shfuqizimin e vendimit të sipërpërmendur. Hetimet e kryera për këtë çështje nga organi i akuzës janë të mbështetura ligjërisht. Në nenin 66 të Kodit Penal, ligjvënësi ka parashikuar shuarjen e ushtrimit të ndjekjes penale për rastet kur është kryer vepër penale, e cila do të

thotë se fakti ekziston dhe parashikohet nga ligji si vepër penale dhe jo kur fakti kriminal nuk ekziston. Arsye, midis të tjerave është prishur vendimi i pushimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke mos pranuar gjatë shqyrtimit gjyqësor edhe pretendimet e prokurorit për shuarjen e ushtrimit të ndjekjes penale të kësaj figure vepre penale, përderisa ekzistenca apo jo e një fakti të tillë nuk dihej dhe për të konkluduar lidhur me të, duhej hetuar më parë.”

Kjo përgjigje i është dërguar zyrtarisht me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2015, ankuesit nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Shtetasja K.Rr., ka bërë letër ankesë ndaj prokurorit Klodjan Braho drejtuar Ambasadës Amerikane, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, etj., duke u ankuar për të disatën herë në lidhje me procedimin penale nr. ***, të vitit 2012 të hetuar nga prokurori Klodjan Braho. Përmbajtja e ankesës së kësaj shtetase është trajtuar edhe në vendimin e mosfillimit të kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2013, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Po kështu, nga Prokuroria e Përgjithshme i është kthyer përgjigje kësaj shtetaseje me shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2016, ku është sqaruar se problemet e ngritura prej saj janë çështje objekt gjykimi në një procedim penale, për të cilin nuk ka përfunduar ende shqyrtimi gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Lidhur me këto çështje subjektit iu kërkua shpjegim, i cili ka dërguar edhe provat në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰.

Në përfundim, pas përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional për pesë çështjet e shortuara për subjektin e rivlerësimit dhe çështjet e ndjekura nga prokuroritë e rretheve dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Trupi gjykues nuk gjeti asnjë indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e magjistratit.

D. DENONCIMET

Në Komision janë paraqitur dhe shtatë denoncime të tjera si më poshtë:

1. Ankim nga shtetasi A.E., protokolluar në Komision në datën 25.3.2019. Ankuesi kërkon të verifikohet dhe të monitorohet dosja që po gjykohet nga gjyqtarë dhe prokurorë, ndër të cilët edhe subjekti i rivlerësimit.
2. Informacion nga shtetasi M.K., protokolluar në Komision në datën 26.2.2019. Denoncuesi kërkon të verifikohet veprimtaria e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e detyrës.
3. Denoncim nga shtetasi L.Z., protokolluar në Komisioni në datën 11.4.2019. Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit se nuk është pritur në takim dhe se është ndërruar prokurori për këtë çështje.
4. Denoncim nga shtetasi A.M., protokolluar në Komision në datën 11.4.2019. Denoncuesi ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shpërdorim detyre dhe moshetim të veprës penale. Rezulton se subjekti ka shqyrtuar dhe ka dalë me vendim mbi kallëzimin e kryer nga shtetasi A. M., dhe ka vendosur mosfillim procedimi penal dhe transferimin e çështjes për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Fier.

¹⁰ Shikoni përgjigjen e subjektit të datës 22.7.2019, protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot.

5. Denoncim nga shtetasi P.Dh., protokolluar në Komision në datën 15.4.2019. Denoncuesi ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për veprime arbitrare dhe të padrejta. Denoncuesi ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe denoncon subjektin e rivlerësimit për ngritje akuze të pambështetur në ligj.
6. Denoncim nga shtetasi F.Ç., protokolluar në Komision në datën 30.1.2019. Denoncuesi ka paraqitur ankim në gjykatë për kundërshtim vendimi për mosfillim procedimi penal të vitit 2018 të subjektit të rivlerësimit dhe çështja është në kompetencën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.
7. Denoncim nga shtetasi M.S., protokolluar në Komision në datën 29.1.2019. Denoncuesi ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për mungesë profesionalizmi dhe integriteti.

Këto denoncime u analizuan nga Komisioni, si dhe iu kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti paraqiti shpjegimet e tij të detajuara¹¹, si dhe procedurat që ka ndjekur lidhur me çështjet e denoncuar.

Këto shpjegime dhe provat e paraqitura nga subjekti u vlerësuan nga Komisioni nga të cilat nuk rezultoi ndonjë problematikë lidhur me procedurën e ndjekur nga subjekti për këto çështje.

Në përfundim

Komisioni, pasi analizoi denoncimet e sipërpërmendura, konstaton se ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, nga verifikimi i denoncimeve nuk u konstatuan indice për veprime korruptive apo kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit.

Mbështetur në raportin e vlerësimit profesional për çështjet e shortuara dhe denoncimet e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultoi të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram

¹¹ Shikoni shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 22.7.2019, protokolluar në Komision me shkresën nr. *** prot.

të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Klodjan Braho, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Klodjan Braho, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesues/Kundër

Valbona SANXHAKTARI
Anëtar

Roland ILIA
Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore